



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS  
REKTORATI

---

**RREGULLORE**

**PËR**

**HETIMIN ADMINISTRATIV TË KËRKESËS SË SINJALIZUESIT PËR MBROJTJEN**

**NGA HAKMARRJA NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS**

## **KREU I RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Baza ligjore**

Rregullorja për hetimin administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja në Universitetin Politeknik të Tiranës, bazohet në ligjin nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”, ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara.

### **Neni 2 Objekti**

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtjen nga hakmarrja, në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “*Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve*”.

### **Neni 3 Përkufizime**

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë në ligjin për të drejtën e informimit.
2. “Hakmarrje” është çdo veprim, i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë, ose kërcënim, i kryer nga organizata, me natyrë diskriminuese, disiplinore ose që, në një formë tjetër të padrejtë, dëmton interesat e ligjshëm të sinjalizuesit dhe që rezulton nga sinjalizimi.
3. “I sinjalizuar” janë një ose më shumë persona, ndaj të cilëve bëhet një sinjalizim, sipas ligjit nr. 60/2016, në lidhje me një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
4. “UPT” është Universiteti Politeknik i Tiranës.
5. “ILDKPKI” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.
6. “Mbrojtje” është mbrojtja e sinjalizuesit nga hakmarrja, sipas mekanizmit të përcaktuar në kreun V të ligjit nr. 60/2016.

7. “Njësia përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës të organizatës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit.
8. “Organizatë” është autoriteti publik (Universiteti Politeknik i Tiranës)
9. “Sinjalizim” është raportimi i informacionit nga ana e sinjalizuesit tek njësia përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për veprime apo praktika të dyshuara korrupsioni, të kryera në vendin e tij të punës në autoritetin publik apo subjektin privat.
10. “Sinjalizues” është individ, i cili aplikon ose është në marrëdhënie pune, ose ka punuar më parë pranë autoritetit publik apo subjektit privat, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguhet ose jo, që sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni.
11. “Subjekt privat” është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin, sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.
12. “Veprim ose praktikë e dyshuar korrupsioni” është një veprim ose mosveprim, fakte ose rrethana të kryera në një organizatë, për të cilat sinjalizuesi dyshon në mirëbesim, sipas këtij ligji, se mund të përbëjë korrupsion.

## **KREU II**

### **VEPRIMET PROCEDURALE**

#### **Neni 4**

#### **Kryerja e veprimeve procedurale**

1. Veprimet procedurale të njësisë përgjegjëse në Universitetin Politeknik të Tiranës, kryhen në përputhje me ligjin nr. 60/2016 dhe në rast të mosparashikimit nga ky ligj, sipas Kodit të Procedurave Administrative.
2. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat njësia përgjegjëse cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

#### **Neni 5**

#### **Mbrojtja kundër hakmarrjes**

1. Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, sipas ligjit nr. 60/2016, mbrohet ndaj çdo masë hakmarrëse të marrë ndaj tij nga organizata, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

- a. shkarkimin nga puna;
  - b. pezullimin nga puna, ose të një, ose më shumë detyrave;
  - c. transferimin brenda ose jashtë organizatës;
  - d. uljen në detyrë;
  - e. uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
  - f. humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
  - g. mosngritjen në detyrë;
  - h. heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
  - i. vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
  - j. forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.
2. Çdo akt i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit është i pavlefshëm.
  3. Nëse sinjalizuesi dëshiron të vendoset në një strukturë tjetër të Universitetit Politeknik të Tiranës, për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës, paraqet kërkesë me shkrim tek Njësia Përgjegjëse dhe një kopje e saj i dërgohet Rektorit ose Administratorit të institucionit.
  4. Organizata merr masat e arsyeshme dhe të përshtatshme për të lehtësuar një lëvizje të tillë. Në rast se UPT nuk merr asnjë masë për transferimin e sinjalizuesit, ky i fundi i drejtohet me kërkesë të arsyetuar ILDKPKI-së.

### **KREU III**

#### **HETIMI ADMINISTRATIV**

##### **Neni 6**

##### **Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje**

1. Sinjalizuesi, i cili pretendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje, fillimisht duhet të paraqesë kërkesë për mbrojtje tek Njësia Përgjegjëse e UPT.
2. Njësia Përgjegjëse merr menjëherë masat dhe në çdo rast, jo më vonë se 10 ditë nga paraqitja e kërkesës, vendos me akt të ndërmjetëm të arsyetuar për riparimin e pasojave të paligjshme nga akti i hakmarrjes. Në rast të shkeljes së këtij afati, kërkesa e sinjalizuesit paraqitet tek ILDKPKI-ja, që vendos brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës për riparimin e pasojave të paligjshme të aktit të hakmarrjes.
3. Njësia Përgjegjëse, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së një kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja, njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e pretendimit dhe emrin e personit pranë saj, i cili do të ndjekë çështjen. Përmbajtja e regjistrimit të posaçëm për këtë

qëllim përcaktohet me urdhër të veçantë të ILDKPKI.

#### **Neni 7**

##### **Hetimi administrativ dhe barra e provës**

1. Njësia Përgjegjëse pranë UPT heton administrativisht pretendimet për hakmarrje për të përcaktuar nëse ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur, është duke ndodhur, ose pritet të ndodhë një akt hakmarrjeje.
2. Njësia Përgjegjëse pranë UPT, në hetimin administrativ, i kërkon me shkresë të provojë që masat e marra në dëm të sinjalizuesit janë bazuar në shkaqe të ndryshme dhe që nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sinjalizimin. Organizata ka barrën e provës në këtë proces dhe i përgjigjet Njesisë Përgjegjëse me shkrim brenda 10 ditësh nga data e marrjes së kërkesës.

#### **Neni 8**

##### **Bashkëpunimi**

1. Organi/njësia strukturore dhe sinjalizuesi bashkëpunon me njësinë përgjegjëse në përcaktimin e fakteve dhe rrethanave të nevojshme për zgjidhjen e çështjes së aktit të hakmarrjes ndaj sinjalizuesit. Organi/njësia strukturore është e detyruar të paraqesë informacione, prova, dokumente, deklarata apo për t'u paraqitur personalisht përpara Njesisë Përgjegjëse.
2. Organi/njësia strukturore çdo deklaram apo argument të saj e paraqet me shkrim.

#### **Neni 9**

##### **Mjetet e kërkimit të provës**

1. Gjatë hetimit administrativ Njësia Përgjegjëse me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen mund:
  - a. të mbledhë deklarata nga palët, dëshmitarët dhe ekspertë;
  - b. të marrë dokumente dhe dokumente të tjera të dokumentuara nëpërmjet mjeteve fotografike, të regjistrimit ose mjeteve të tjera teknike;
  - c. të vizitojë vende të caktuara.
2. Kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e çështjes së aktit të hakmarrjes ose që ndikon në sqarimin e saj, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet ose bëhet e pamundur marrja e saj, Njësia Përgjegjëse kryesisht apo me kërkesën e sinjalizuesit, mund të vendosë marrjen më parë të kësaj prove (sigurimi i provës).
3. Njësia Përgjegjëse që zhvillon procedurën administrative mund të vendosë sigurimin e provës edhe përpara fillimit të procedurës administrative. Sigurimi i provës mund të bëhet edhe në

çdo fazë të procedurës administrative. Përgjegjësia për sigurimin e provave bie mbi Njësinë Përgjegjëse.

#### **Neni 10** **Njoftimi i sinjalizuesit**

1. Njësia Përgjegjëse njofton me shkrim sinjalizuesin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për statusin e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë.
2. Pavarësisht nga afatet e njoftimit, Njësia Përgjegjëse është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion me shkrim, paraqitur në çdo kohë nga sinjalizuesi në lidhje me kërkesën e tij.

#### **KREU IV** **AFATI PËR PROCEDURËN E HETIMIT**


#### **Neni 11** **Masat në përfundim të hetimit administrativ**

1. Nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se është kryer një akt hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit nga autoriteti publik, Njësia Përgjegjëse i drejtohet me shkrim organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi, për të urdhëruar autoritetin publik për marrjen e të gjitha masave për riparimin e shkeljes së kryer.
2. Njësia Përgjegjëse parashikon në shkresë edhe rekomandimin konkret për llojin e masës që duhet të merret.

#### **Neni 12** **Afati i përfundimit të hetimit administrativ**

Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje nga hakmarrja përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.



**REKTORI**  
Prof. Dr. Andrea MALIQARI



**ADMINISTRATORI**

Besmir ALI